LIGJ
Nr. 112/2015

PËR INSPEKTIMIN FINANCIAR PUBLIK

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton qëllimin, parimet dhe rregullat e përgjithshme të inspektimit financiar publik, si dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave të përfshira në proces.

Neni 2
Misioni

Misioni i inspektimit financiar publik është garantimi i zbatimit të ligjshmërisë në përdorimin e fondeve publike dhe dhënia e ndihmës në përmirë-simin e menaxhimit financiar publik.

Neni 3
Qëllimi i ligjit

Ky ligj ka si qëllim mbrojtjen e interesave financiarë të njësive publike, kundrejt keqmena-xhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

Neni 4
Fusha e zbatimit të ligjit

Subjekt i inspektimeve financiare publike janë:

a) njësitë e qeverisjes së përgjithshme;

b) shoqëritë shtetërore, organizatat jofitim-prurëse dhe autoritetet e përbashkëta që zotërohen, kontrollohen, financohen ose garantohen financiarisht nga një njësi e qeverisjes së përgjith-shme, ose në të cilën një njësi e qeverisjes së përgjithshme zotëron apo kontrollon një pjesë të aksioneve, e cila i jep të drejtën e kontrollit;

c) çdo person fizik apo juridik, vetëm për fondet që përfiton nga Buxheti i Shtetit, Bashkimi Europian apo fondet në bazë të një marrëveshjeje ndërkombëtare, ku përfitues është shteti shqiptar.

Neni 5
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "AFCOS" është "Shërbimi i koordinimit të antimashtrimit", i caktuar në Shqipëri për të lehtësuar bashkëpunimin me organet përkatëse të Bashkimit Europian.

2. "Dëm pasuror", kuptimi i këtij termi është i njëjtë me atë të parashikuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

3. "Fonde publike" janë të gjitha fondet, përfshirë fondet e Bashkimit Europian dhe të donatorëve të tjerë, të cilat mblidhen, arkëtohen, mbahen, shpërndahen dhe shpenzohen nga njësitë publike dhe që përbëhen nga të ardhurat, shpenzimet, kreditë dhe grantet për njësitë publike.

4. "Garanci financiare" është shuma e ngurtësuar në zbatim të një marrëveshjeje, të nënshkruar nga njësia e qeverisjes së përgjithshme, për të siguruar përmbushjen e një kontrate ose veprime të

tjera, të ndërmarra nga një palë e tretë.

5. "Inspektor financiar publik" është personi i ngarkuar për kryerjen e inspektimit financiar publik.

6. "Keqmenaxhim i rëndë financiar" është veprimi ose mosveprimi i një titullari apo nëpunësi të një njësie publike, që mund të rezultojë ose ka rezultuar me paaftësi paguese financiare të njësisë ose me humbje të rëndësishme, përtej humbjeve /parashikimeve në buxhetin e miratuar.

7. "Marrëveshje ndërkombëtare" janë marrëveshjet ku përfitues është shteti shqiptar, kuptimi i të cilave jepet në ligjin "Për lidhjen e traktateve dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare".

8. "Mashtrim", "Vjedhje", "Shkatërrim i pronës", "Shpërdorim i detyrës", "Korrupsion" kanë kuptim të njëjtë me atë të parashikuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë.

9. "Njësi të qeverisjes së përgjithshme" ka të njëjtin kuptim me përcaktimin në ligjin për menaxhimin e sistemit buxhetor.

10. "OLAF" është Zyra Europiane Kundër Mashtrimit.

11. "Organizata jofitimprurëse" ka kuptimin sipas përkufizimit të dhënë në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin "Për organizatat jofitimprurëse".

12. "Parregullsi" është moszbatimi ose zbatimi i gabuar i ligjeve apo akteve të tjera nënligjore, që e ka origjinën te veprimet a mosveprimet e përdoruesit të fondeve publike, të cilat kanë ose mund të kenë pasoja të dëmshme për menaxhimin e fondeve publike, pavarësisht nëse ajo prek të ardhurat/të hyrat, shpenzimet/të dalat, fondet e kthyera mbrapsht, aktivin apo detyrimet financiare.

13. "Shoqëri shtetërore" ka kuptim të njëjtë me atë të parashikuar në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 6

Parimet e inspektimit financiar publik

Inspektimi financiar publik realizohet sipas parimeve të përgjithshme të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Veprimtaria e inspektimit financiar publik

1. Inspektimi financiar publik është veprimtari që kryhet pas faktit, për rregullshmërinë e transaksioneve dhe veprimtarive të tjera të menaxhimit financiar, të kryera nën përgjegjësinë e njësive publike dhe individëve, në mënyrë që:

a) të përcaktojë shkeljet e akteve normative, si dhe të provojë dyshimet për mashtrimet e kryera;

b) të zbulojë parregullsitë dhe dëmet e shkaktuara në pronën e njësive publike;

c) të identifikojë individët përgjegjës për shkeljet e kryera dhe të kërkojë marrjen e masave zhdëmtuese, administrative apo disiplinore, sipas shkallës apo llojit të përgjegjësisë.

2. Kjo veprimtari kryhet nga punonjësit e njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik në Ministrinë e Financave. Në rastet e mungesës së burimeve njerëzore, si dhe mbulimit të fushave specifike të inspektimit financiar publik, angazhohen punonjës të administratës publike ose ekspertë të jashtëm. Procedurat e përzgjedhjes dhe të shpërblimit të ekspertëve të jashtëm, punonjës të administratës publike apo jashtë saj, të cilët do të angazhohen në kryerjen e inspektimit financiar publik, rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të propozuar nga Ministri i Financave.

Neni 8

Baza për fillimin e inspektimit financiar publik

1. Inspektimi financiar publik nis vetëm mbi bazën e kërkesës, informacionit apo ankesës.

2. Burimet e kërkesës, informacionit apo ankesës janë:

a) kërkesa nga Presidenti i Republikës;

b) kërkesa nga Kryeministri;

c) kërkesa nga Ministri i Financave;

ç) kërkesa nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

d) kërkesa nga Prokurori i Përgjithshëm;
dh) kërkesa nga titullarët dhe nëpunësit autorizues të njësive publike;
e) kërkesa nga OLAF-i;
ë) informacione për parregullsi nga auditimi i brendshëm;
f) informacione të menaxhimit financiar dhe kontrollit;
g) ankesa nga punonjës në sektorin publik apo privat;
gj) ankesa nga çdo person fizik/juridik;
h) informacione apo ankesa nga persona anonimë, kur në to ekzistojnë elemente të keqmenaxhimit të rëndë financiar, mashtrimit, vjedhjes, shkatërrimit të pronës, shpërdorimit të detyrës apo korrupsionit.

KREU II
AUTORITETET VENDIMMARRËSE TË INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

Neni 9
Detyrimet e Ministrit të Financave

1. Ministri i Financave është përgjegjës për rregullimin e funksionimit të centralizuar të inspektimit financiar publik.
2. Ministri i Financave nxjerr urdhra, udhëzime dhe miraton metodologji për:
a) kriteret për fillimin e inspektimit financiar publik, duke përfshirë dhe rëndësinë e shkeljes;
b) rregullat dhe procedurat e kryerjes së inspektimit financiar publik;
c) kodin e etikës për inspektorët financiarë publikë.
3. Ministri i Financave, bazuar në raportin përfundimtar të inspektimit, në vlerësimin e drejtuesit të njësisë përgjegjëse të inspektimit financiar publik, si dhe në miratimin e nëpunësit të parë autorizues, urdhëron marrjen e masave rregulluese, zhdëmtuese, administrative apo disiplinore.
4. Ministri i Financave cakton organet që formojnë rrjetin e raportimit të shërbimit AFCOS, ku bëjnë pjesë të gjitha autoritetet kombëtare, të përfshira në parandalimin, raportimin dhe eliminimin e parregullsive që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Europian, me të cilat lidh marrëveshje bashkëpunimi.
5. Ministri i Financave, me propozim të nëpunësit të parë autorizues, heq nga lista e inspektorëve financiarë publikë punonjësit e administratës publike dhe ekspertët e jashtëm, në rast të shkeljeve në përmbushjen e detyrave gjatë kryerjes së veprimtarisë së inspektimit financiar publik.

Neni 10
Të drejtat e Ministrit të Financave

1. Bazuar në raportin e inspektimit financiar publik, në vlerësimin e drejtuesit të njësisë përgjegjëse të inspektimit financiar publik, si dhe në miratimin e nëpunësit të parë autorizues, Ministri i Financave ka të drejtë:
a) t'i propozojë titullarit të njësisë të ndërmarrë masat e duhura, me qëllim përfundimin e parregullsive ose/dhe shmangien e pasojave negative të këtyre veprimtarive;
b) t'i propozojë autoritetit përgjegjës, të ndërmarrë veprime të mëtejshme, të nevojshme, kur individi përgjegjës është një ministër ose titullar i njësisë së qeverisjes së përgjithshme;
c) t'u kërkojë autoriteteve përgjegjëse ndalimin e veprimtarive që çojnë në parregullsi ose që u shkaktojnë dëme njësive dhe individëve, subjekte të inspektimit;
ç) t'u kërkojë autoriteteve përgjegjëse ose titullarëve të njësive dhe individëve shfuqizimin / revokimin e akteve administrative, të lëshuara në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi;
d) t'u kërkojë autoriteteve përgjegjëse marrjen e masave për zhdëmtim dëmi ose masave administrative apo disiplinore, sipas procedurave përkatëse.
2. Në rastet e moszbatimit të shkronjave "c", "ç" dhe "d", të pikës 1, të këtij neni, Ministri i Financave, me propozim të nëpunësit të parë autorizues, mund të urdhërojë:
a) bllokimin e përdorimit të fondeve buxhetore, të përcaktuara në ligjin vjetor të Buxhetit të

Shtetit për vitin përkatës, në nivel programi, zëri apo projekti, deri në raportimin për zbatimin e masave të marra, sipas pikës 1 të këtij neni;

b) bllokimin e llogarive bankare të njësive publike, lidhur me fondet ku janë zbuluar parregullsi, deri në eliminimin e parregullsive.

Neni 11

Funksionet e nëpunësit të parë autorizues

1. Nëpunësi i parë autorizues është autoriteti përgjegjës për fillimin e inspektimit financiar publik. Vendimi i nëpunësit të parë autorizues merret bazuar në mendimin e njësisë përgjegjëse të inspektimit financiar publik.

2. Nëpunësi i parë autorizues, në rastet e ankesave, para se të marrë vendim për nisjen e inspektimit financiar publik, kur është e mundur, kërkon kryerjen e një inspektimi paraprak nga titullari i njësisë respektive apo njësisë publike që mbulon fushën specifike që lidhet me ankesën.

3. Nëpunësi i parë autorizues i dërgon subjektit të inspektuar urdhrin e Ministrit të Financave për përfundimin e inspektimit financiar publik, së bashku me raportin përfundimtar të inspektimit. Një kopje e raportit të inspektimit i dërgohet edhe Kontrollit të Lartë të Shtetit.

4. Për fondet e Bashkimit Europian, funksionet e nëpunësit të parë autorizues për inspektimin financiar publik i kryen Zyrtari Kombëtar Autorizues (NAO/ZKA).

KREU III

NJËSIA PËRGJEGJËSE PËR INSPEKTIMIN FINANCIAR PUBLIK

Neni 12

Struktura e njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik

1. Njësia përgjegjëse për inspektimin financiar publik është pjesë e strukturës së Ministrisë së Financave.

2. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve të njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik, rregullohen nga legjislacioni në fuqi për nëpunësin civil.

3. Punonjësi i njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik, në pozicionin e drejtuesit të njësisë, duhet të ketë diplomë universitare "Master i shkencave" ose ekuivalente me të, në shkencat ekonomike ose juridike, si dhe së paku 10 vjet përvojë profesionale në njësitë publike.

4. Punonjësi i njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik, në pozicionin e inspektorit të kësaj njësie, duhet të ketë diplomë universitare "Master i shkencave" ose ekuivalente me të, si dhe të paktën 5 vjet përvojë profesionale në njësitë publike.

Neni 13

Funksionet e njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik

Njësia përgjegjëse për inspektimin financiar publik përmbush këto funksione:

1. Shqyrton kërkesat, informacionet apo ankesat dhe jep mendim te nëpunësi i parë autorizues për fillimin ose jo të inspektimit financiar publik apo të inspektimit paraprak.

2. Kryen inspektime financiare publike, sipas rregullave të miratuara nga ministri i Financave, si edhe është përgjegjëse për cilësinë e tyre.

3. Propozon te nëpunësi i parë autorizues dhe te Ministri i Financave masat që duhet të ndërmerren në përfundim të inspektimit financiar publik.

4. Monitoron zbatimin e masave të kërkuara nga Ministri i Financave në përfundim të inspektimit financiar publik, si dhe informon nëpunësin e parë autorizues për zbatueshmërinë e tyre.

5. Propozon për miratim urdhra, udhëzime dhe metodologji, sipas dispozitave të këtij ligji.

6. Kryen rolin e AFCOS-it dhe shërben si pikë kontakti e OLAF-it.

7. Paraqet te nëpunësi i parë autorizues dhe te Ministri i Financave raportin vjetor të veprimtarisë, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

8. Kërkon dhe shkëmben informacion me njësi të tjera publike, në fushën e veprimtarisë së

inspektimit financiar publik.

Neni 14
Funksionet e AFCOS-it

1. AFCOS-i koordinon, brenda vendit, të gjitha detyrimet ligjore, administrative, operative dhe aktivitetet që lidhen me mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së.

2. Të drejtat e AFCOS-it janë:

a) t'i kërkojë autoritetit administrativ kombëtar përkatës ose autoritetit ligjor përkatës të analizojë informacionin, me qëllim fillimin e hetimeve;

b) t'i kërkojë autoritetit të sipërpërmendur të fillojë hetimin administrativ, nëse është e nevojshme;

c) të kërkojë të jetë i informuar për rezultatet e hetimit;

ç) të sigurojë shkëmbimin efektiv të informacionit me OLAF-in.

3. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, AFCOS-i ka për detyrë:

a) të jetë përgjegjës për pranimin e kontrolleve në vend dhe identifikimin konkret të autoriteteve administrative ose ligjore që mund t'i ofrojnë OLAF-it ndihmën e nevojshme;

b) të vendosë OLAF-in në kontakt me autoritetet kombëtare, në mënyrë që të sigurojnë bashkëpunimin operacional për rastet e hetimit;

c) të parashikojë mundësinë e krijimit të ekipeve të përbashkëta hetimore administrative apo inspek-tuese midis OLAF-it dhe autoriteteve kombëtare;

ç) të organizojë takime periodike me autoritetet kombëtare administrative dhe ligjore, në mënyrë që të informohet vazhdimisht për zhvillimin e hetimeve dhe të ndërhyjë në rast vonesash ose në rastin e mbështetjes së dobët nga ana e autoriteteve;

d) të sigurojë shkëmbimin efektiv të informa-cionit me OLAF-in.

Neni 15
Detyrimi për të dhënë informacion

Njësia përgjegjëse për inspektimin financiar publik jep informacion për inspektimet financiare publike të kryera, kur informacioni kërkohet nga autoritetet publike, të cilëve u jepet e drejta me ligj.

Neni 16
Të drejtat e inspektorëve financiarë publikë

Për zbatimin e detyrave të tyre, inspektorët financiarë publikë kanë këto të drejta:

a) hyrje të pakufizuar në mjediset e njësisë që është subjekt i inspektimit;

b) qasje të pakufizuar lidhur me inspektimin ndaj gjithë informacionit, sistemit të kontabilitetit, dokumentacionit elektronik dhe atë të klasifikuar, sipas nivelit të tyre të aksesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

c) kërkim të dokumenteve origjinale, të kopjeve zyrtare të dokumenteve, të informacionit dhe të referencave, të deklarimeve për të gjitha llogaritë bankare, si në vend dhe jashtë tij, si dhe të çdo dokumenti tjetër që ka lidhje me objektin e inspektimit financiar, në afate të përcaktuara;

ç) ushtrim të kontrolleve dhe të kërkimit të kopjeve zyrtare të dokumenteve, të informacionit dhe të referencave personave juridikë e fizikë, jashtë subjektit të inspektimit financiar, vetëm në lidhje me objektin e inspektimit financiar publik;

d) parandalim të hyrjes së individëve përgjegjës te kasafortat, magazinat dhe artikuj të tjerë, subjekte të inspektimit, duke i vulosur në praninë e një zyrtari nga njësia subjekt i inspektimit.

Neni 17
Detyrimet e inspektorëve financiarë publikë

1. Për ushtrimin e detyrave të tyre, inspektorët financiarë publikë janë të detyruar:

a) të identifikohen me një dokument identifikimi zyrtar dhe me vendimin e caktimit për kryerjen e

detyrës së inspektimit financiar publik;

b) të raportojnë objektivisht dhe në mënyrë të saktë rezultatet e veprimtarisë së inspektimit të kryer, parregullsitë, shkeljet dhe dëmet e konstatuara, shkaqet e ndodhjes së tyre, në bazë të fakteve dhe të rrethanave të kontrolluara zyrtarisht nga ata;

c) të ruajnë sekretin për çdo fakt ose rrethanë të siguruar gjatë procesit të zbatimit të detyrave të tyre, me përjashtim të rasteve të lejuara me ligj;

ç) të kërkojnë ndërprerjen e çdo veprimi që gjykojnë se çon në kryerjen e një parregullsie;

d) të njohin dhe të zbatojnë kodin e etikës për inspektorët financiarë publikë.

2. Inspektorët financiarë publikë mund të pezullohen nga misioni i inspektimit, me propozim të drejtuesit të njësisë përgjegjëse për inspektimin financiar publik dhe me miratim të nëpunësit të parë autorizues, para përfundimit të misionit në këto raste:

a) kur vërtetohet ekzistenca e kushteve të konfliktit të interesit;

b) për shkelje gjatë kryerjes së inspektimit ose paaftësi në përmbushjen e inspektimit financiar publik.

Neni 18

Konflikti i interesit për inspektorët financiarë publikë

Konflikti i interesit për inspektorët financiarë publikë përfshin rastet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi që rregullon konfliktin e interesit, si dhe rastet kur:

a) në tre vitet e fundit të kenë punuar për njësinë ose për individin subjekt të inspektimit;

b) në tre vitet e fundit të kenë qenë pjesëmarrës në autoritetet menaxhuese ose mbikëqyrëse të njësive dhe/ose individëve subjekt inspektimi;

c) bashkëshorti/bashkëshortja apo bashkë-jetuesi ose të afërmit deri në shkallë të dytë të kenë qenë të punësuar në tre vitet e fundit si autoritete menaxhuese ose mbikëqyrëse në njësitë subjekt inspektimi.

Neni 19

Të drejtat e subjekteve të inspektuara

1. Subjektet e inspektimit kanë të drejtë:

a) të kërkojnë të njihen me vendimin për fillimin e inspektimit financiar publik;

b) të kërkojnë identifikimin e inspektorëve financiarë publikë;

c) të jenë të pranishëm dhe të ndjekin, vetë ose nëpërmjet përfaqësuesit të tyre, të gjitha veprimet e inspektimit;

ç) të kërkojnë dhe të marrin informacion nga inspektori për procedurën e inspektimit dhe për çdo veprim apo vendim të ndërmarrë gjatë saj;

d) të paraqesin, me shkrim apo me gojë, mendimet, shpjegimet për faktet, rrethanat apo edhe për çështjet ligjore që kanë të bëjnë me inspektimin;

dh) të kërkojnë të njihen dhe t'u njoftohet procesverbali dhe aktkonstatimi i inspektimit;

e) të paraqesin kontestimet e tyre për vlerësimin e provave të administruara, për rezultatet e inspektimit dhe për vendimin që synohet të merret në përfundim të inspektimit.

2. Kur pjesëmarrja, gjatë kryerjes së inspektimit, sipas shkronjës "c", të pikës 1, të këtij neni, pengon kryerjen e veprimeve të inspektimit, inspektori mund të vendosë përjashtimin nga pjesëmarrja. Vendimi pasqyrohet në procesverbal dhe nuk mund të ankimohet veçmas.

Neni 20

Detyrimet e subjekteve të inspektuara

1. Çdo subjekt inspektimi është i detyruar:

a) të bashkëpunojë dhe të mos pengojë inspektorët financiarë publikë në procesin e ekzekutimit të detyrave të tyre;

b) t'u ofrojë inspektorëve financiarë publikë të drejtën e përdorimit të pakufizuar të mjediseve ku do të punojnë dhe të të gjithë dokumentacionit që lidhet me objektin e inspektimit;

c) të dorëzojë, brenda afateve të përcaktuara prej inspektorëve financiarë publikë, dokumentet, kopjet zyrtare të dokumenteve, informacionin dhe deklaratat për çdo llogari bankare dhe shpjegime të shkruara, si dhe raportet;

ç) të dorëzojë, brenda afateve të përcaktuara prej inspektorëve financiarë publikë, të dhëna të sakta, deklarimet dhe kopjet zyrtare të dokumen-teve që kanë lidhje me objektin e inspektimit;

d) të zbatojë masat e kërkuara nga Ministri i Financave, sipas shkronjave "c", "ç" e "d", të pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji, dhe, brenda një periudhe prej dy muajsh pas njoftimit të marrë, të informojë me shkrim nëpunësin e parë autorizues për masat e marra.

2. Çdo person fizik apo juridik subjekt inspektimi, sipas pikës 1, të këtij neni, nuk ka të drejtë të refuzojë dhënien e informacionit, duke iu referuar inspektimeve të mëparshme, kontrolleve nga njësitë e tjera ose sekretit bankar, si dhe informacionit të klasifikuar sekret shtetëror ose sekret profesional, për fushën objekt inspektimi dhe vetëm për personin e tij.

Neni 21

Përmbushja e inspektimit financiar publik

1. Inspektimi financiar publik kryhet në bazë të akteve nënligjore të miratuara nga Ministri i Financave, sipas pikës 2, të nenit 9, të këtij ligji.

2. Rregullat dhe procedurat për kryerjen e inspektimit financiar publik miratohen nga Ministri i Financave. Ato përmbajnë të gjitha proceset që kryhen gjatë një shërbimi inspektimi, pas marrjes së vendimit për fillimin e tij, deri në zbatimin e masave të kërkuara nga Ministri i Financave, sipas pikës 1, të nenit 10, të këtij ligji.

Neni 22

Informimi i autoriteteve

1. Informacioni për rezultatet e inspektimit financiar, të kryer në njësitë e qeverisjes qendrore dhe njësitë shpenzuese të fondeve publike, duhet t'i dorëzohet një njësie të një niveli më të lartë, kur përmban parregullsi.

2. Në rastin e inspektimit financiar të organeve të njësive të qeverisjes vendore dhe të njësive të tyre shpenzuese të fondeve publike, informacioni duhet t'i dërgohet, gjithashtu, këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, kur vërehen parregullsi.

3. Informacioni për rezultatet e inspektimit financiar, sipas shkronjës "b", të nenit 4, të këtij ligji, kur vërehen parregullsi, duhet t'i dërgohet autoritetit më të lartë që ushtron të drejtën e pronës shtetërore ose vendore te kapitali i njësisë ose individit që inspektohet.

KREU IV
SHKELJET DHE ANKIMET

Neni 23

Përgjegjësia për shkaktimin e dëmit

1. Për çdo dëm shkaktuar njësive publike dhe individëve, të vërejtur gjatë inspektimit financiar publik, duhet të mbahet përgjegjësi, sipas dispozitave të Kodit Civil.

2. Kur dëmi është shkaktuar nga shumë persona së bashku, këta përgjigjen solidarisht për dëmin, në bazë të dispozitave të Kodit Civil.

3. Çdo person që ka urdhëruar ose kryer pagesa në kundërshtim me ligjet në fuqi apo që ka marrë përsipër angazhime jashtë fondeve të parashikuara në buxhet është përgjegjës për shlyerjen e detyrimit.

Neni 24

Shkeljet penale

Kur të dhënat tregojnë dyshime të arsyeshme për ekzistencën e një vepre penale, nëpunësi i parë

autorizues informon Ministrin e Financave dhe bën kallëzim me shkrim në prokurori.

Neni 25

Masat disiplinore

Kur inspektori financiar publik, punonjës i administratës publike, kryen shkelje gjatë përmbushjes së inspektimit, me kërkesë të drejtuesit të inspektimit financiar publik, nëpunësi i parë autorizues i kërkon autoritetit përgjegjës ku është i punësuar punonjësi fillimin e ecurisë disiplinore.

Neni 26

Ankimi në rrugë gjyqësore

Kundër masave të kërkuara nga Ministri i Financave, sipas pikave 1 dhe 2, të nenit 10, të këtij ligji, mund të bëhet ankim në gjykatën adminis-trative kompetente, brenda 45 ditëve nga data e marrjes dijeni.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 27

Periudha kalimtare për zbatimin e ligjit

1. Ngarkohet Ministri i Financave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikave 2 dhe 4, të nenit 9, të tij.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 2, të nenit 7, të tij.

Neni 28

Shfuqizimet

1. Ligji nr. 10294, datë 1.7.2010, "Për inspek-timin financiar publik", si dhe çdo akt tjetër ligjor që bie në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

2. Aktet nënligjore, të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 10294, datë 1.7.2010, "Për inspektimin financiar publik", mbeten në fuqi deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, për aq sa nuk bien ndesh me parashikimet e këtij ligji.

Neni 29

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9288, datë 23.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani